



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prudato Received/Deliverty	01. 07 2022	2	viti god year
Organ /Njesta Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM SHUK	3876/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.488/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional-në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1950/2021 të datës 14.04.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr.488/2019 të datës 22.08.2019, të parashtruar nga ankuesi

Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Institutit Pedagogjik i Kosovës, në çështjen juridike "*kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe të Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 30.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.488/2019 të datës 22.08.2019, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi sipas akt emërimit të datës 20.09.2011 është i sistemuar në vendin e punës "*Hulumtues për Arsimin e Vazhdueshëm*" në Institutin Pedagogjik të Kosovës, i cili sipas Vendimit me numër 397 të datës 16.05.2014 të nxjerr nga Drejtori i Institutit Pedagogjik të Kosovës caktohet anëtar i Këshillit Drejtues, më tutje U.d. Drejtori i Institutit Pedagogjik të Kosovës nxjerr vendimin me numër 9-169/15 të datës 17.12.2015 ku lejohet pagesa e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Pedagogjik nga muaji mars-dhjetor të vitit 2015 si dhe me Vendimin me numër 9-1/17 të datës 04.01.2017 U.d. Drejtori i Institutit Pedagogjik të Kosovës u lejohet puna shtesë e jashtë orarit të rregullt të punës si dhe iu njihet kompensimi për periudhën 04.01.2017 gjer më 15.05.2017.

Ankuesi i pa kënaqur me mos kompensimin sipas Vendimeve të lartë cekura me datë 13.06.2019 ka parashtruar kërkesë në organin e punësimit, dhe me datë 19.06.2019 Drejtori i Institut Pedagogjik të Kosovës i kthen përgjigje ankuesit, me ç'rats e njofton se kërkesa e tij është paraqit jashtë afatit ligjor. Ankuesi i pa kënaqur me këtë përgjigje me datë 10.07.2019 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Institut Pedagogjik të Kosovës, i cili komision nuk vendos për ankesën e ankuesit dhe ankuesi i pa kënaqur me heshtjen e organit të punësimit me datë 22.08.2019 parashtron ankesën me numër të protokollit 3743/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 17.10.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 14.04.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1950/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 17.10.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 22.08.2022. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 27.05.2022 me numër të protokollit 3059/2022 e ka pranuar Aktgjykimin A.nr.1950/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 28.09.2019, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Instituti Pedagogjik të Kosovës. Instituti Pedagogjik i Kosovës më datë 09.09.2019 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/9.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Aktgjykim A.nr.1950/2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimi i datës 17.10.2019; Ankesa e ankuesit e datës 22.08.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e ankuesit e datës 10.07.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Institutit Pedagogjik të Kosovës; Propozimi për Përmbarim i datës 31.01.2019; Vendimi i datës 17.12.2015; Vendimi i datës 04.01.2017; Vendimi i datës 16.05.2014; Ankesa e ankuesit e datës 24.05.2019 drejtuar Institut Pedagogjik të Kosovës; Vendimi i datës 29.06.2015; Përgjigja në ankesë e datës 19.06.2019; Akt emërimi i ankuesit si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit sepse:

Bazuar në provat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se nuk është kompetent për shqyrtimin e kësaj çështje, pasi që pozita "Hulumtues për arsimin e vazhdueshëm" në Institutin Pedagogjik të Kosovës nuk hynë në kategorinë e nëpunësve civil pasi si e tillë nuk është e paraparë me Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës pasi që sipas dispozitave ligjore të nenit 7 paragrafit 2 nën paragrafit 2.5 si dhe neni 11 të Ligjit Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore është përcaktuar se: "2. Persona juridik kërkimore-shkencorë janë: 2.5. Institucionet tjera kërkimore -shkencore dhe të arsimit të lartë" si dhe "Institutet kërkimore-shkencore janë institucione të pavarura shkencore publike, publiko-private ose private, kurse ato që formohen në kuadër të institucioneve të shkollimit të lartë janë institute kërkimore-shkencore në përbërje të këtyre institucioneve", rrjedhimisht në bazë të kësaj Instituti Pedagogjik i Kosovës është institut i pavarur, publik që merret me hulumtime, trajnime, vlerësime, eksperimentime dhe inovacione në fushën e arsimit andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi të drejtën e tij mund ta realizoj në pajtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore me të cilat rregullohet marrëdhënia e punës për kategorinë e nëpunësve të administratës të cilët janë të përjashtuar nga shërbimi civil.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji për shqyrtimin e ankesës vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.488/2019 të datës 22.08.2019, e parashtruar nga ankuesi

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.Nr. 488/2019

Valentina Kaçandoli BEKTESHI
Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Institutit Pedagogjik të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Institutit Pedagogjik të Kosovës.
- Arkivit të KPMSHCK-së.

